



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 482/Prot

Tiranë, më 9/5/2016

**Lënda:** Jepet mendim mbi projektvendimin "Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave"

**Drejtuar:** Znj. Ermonela VALIKAJ (FELAJ)  
MINISTËR PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

Tiranë

E nderuar Znj. Ministre,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 2683 Prot, datë 22.04.2016, projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 584 datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave" i ndryshuar, vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Do të sugjeronim që në këtë projektakt të parashikohet edhe një shtesë në Rregulloren e Këshillit të Ministrave, si detyrim që buron nga nenin 31/1/a i ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Pas pikës 27 shtohet pika 27/1 me këtë përmbajtje:

"27/1. Projektaktet që kanë të bëjnë me të dhënat personale, i dërgohen për mendim Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI